



Prishtinë, 30 nëntor 2012
Kodi i ZRRE-së: V_486_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, Nenit 25, Nenit 29 dhe Nenit 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 6 dhe Nenit 18 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Importit dhe Eksportit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në ZRRE me datë 20.09.2012 nga ndërmarrja "HEP - KS SH.P.K", adresa: Luan Haradinaj, Hyr. 1-2, Nr. 21, Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 30 nëntor 2012, nxori këtë:

VENDIM

I. **I LËSHOHET** Licenca për import dhe eksport të energjisë elektrike ndërmarrjes "HEP – KS" SH.P.K me numër licence ZRRE/Li_38/12 për periudhën nga data **30 nëntor 2012** deri **30 nëntor 2017**.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 20.09.2012 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për import dhe eksport të energjisë elektrike nga ndërmarrja "HEP – KS SH.P.K".
 - o ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit për import dhe eksport të energjisë elektrike.
 - o Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Licenca për import dhe eksport të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet deri 100 MW, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar